



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr.662/2024

Përgjegjësia e shtetit në raport me shëndetin mendor të fëmijëve

Për:

Z. Arben Vitia, ministër, Ministria e Shëndetësisë
Znj. Arbërie Nagavci, ministre, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Znj. Albulena Haxhiu, ministre, Ministria e Drejtësisë
Z. Bashkim Ramosaj, kryetar, Komuna e Deçanit
Z. Bexhet Xheladini, kryetar, Komuna e Dragashit
Z. Burim Berisha, kryetar, Komuna e Fushë Kosovës
Z. Agim Aliu, kryetar, Komuna e Ferizajt
Znj. Ljiljana Shubariq, kryetare, Komuna e Graçanicës
Z. Mehmet Ballazhi, kryetar, Komuna e Hanit të Elezit
Z. Ilir Ferati, kryetar, Komuna e Istogut
Z. Besim Ilazi, kryetar, Komuna e Kaçanikut
Z. Kadri Rahimaj, kryetar, Komuna e Kamenicës
Z. Zenun Elezaj, kryetar, Komuna e Klinës
Z. Vladan Bogdanoviq, kryetar, Komuna e Klllokotit
Z. Imri Ahmeti, kryetar, Komuna e Lipjanit
Z. Ekrem Kastrati, kryetar, Komuna e Malishevës

Z. Abdülhadi Krasniç, kryetar, Komuna e Mamushës
Z. Bedri Hamza, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Jugut
Z. Sasha Milosheviq, kryetar, Komuna e Novobërdës
Z. Xhafer Gashi, kryetar, Komuna e Obiliqit
Z. Dragan Petkoviq, kryetar, Komuna e Parteshit
Z. Gazmend Muhaxheri, kryetar, Komuna e Pejës
Z. Shpejtim Bulliqi, kryetar, Komuna e Podujevës
Z. Përparim Rama, kryetar, Komuna e Prishtinës
Z. Shaqir Totaj, kryetar, Komuna e Prizrenit
Z. Smajl Latifi, kryetar, Komuna e Rahovecit
Znj. Katarina Ristiq-Iliq, kryetare, Komuna e Ranillugut
Z. Dalibor Jevtiq, kryetar, Komuna e Shtërpçës
Z. Qemajl Aliu, kryetar, Komuna e Shtimes
Z. Fadil Nura, kryetar, Komuna e Skenderajt
Z. Bali Muharremaj, kryetar, Komuna e Suharekës
Z. Sokol Haliti, kryetar, Komuna e Vitisë
Z. Ferit Idrizi, kryetar, Komuna e Vushtrrisë
Z. Erden Atiq, kryetar, Komuna e Mitrovicës së Veriut
Z. Izmir Zeqiri, kryetar, Komuna e Zubin Potokut
Z. Ilir Peci, kryetar, Komuna e Zveçanit
Z. Lulzim Hetemi, kryetar, Komuna e Leposaviqit
Z. Ramiz Lladrovci, kryetar, Komuna e Drenasit
Z. Ardian Gjini, kryetar, Komuna e Gjakovës
z. Ruzhdi Shehu, kryetar, Komuna e Junikut
Z. Alban Hyseni, kryetar, Komuna e Gjiçanit

Kopje:

Z. Habit Hajredini, drejtor, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 5 maj 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

Shëndeti mendor është një pjesë integrale e shëndetit dhe mirëqenies që i referohet mirëqenies emocionale, përshtatshmërisë së mirësjelljes, aftësisë për t'u ballafaquar me situatat stresuese përgjatë jetës, për të mësuar dhe punuar dhe për të kontribuar në komunitet. Shëndeti mendor është e drejtë bazike e njeriut dhe ka rëndësi të veçantë për zhvillim personal, komunitar dhe socio-ekonomik^{1,2}. Fëmijët e shëndetshëm gëzojnë cilësi më të lartë të jetës dhe funksionojnë mirë në shtëpi, në shkollë dhe në komunitetin e tyre, andaj intervenimi i hershëm dhe trajtimi i çështjeve të shëndetit mendor janë thelbësore për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve.

Qëllimi i këtij Raporti me rekomandime është tërheqja e vëmendjes së institucioneve shtetërore në trajtimin dhe ndërmarrjen e masave në lidhje me shëndetin mendor të fëmijëve, në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësiave ligjore. Raporti gjithashtu do të japë rekomandime specifike dhe konkrete për veprimet që duhet t'i ndërmarrin institucionet përkatëse lidhur me shëndetin mendor të fëmijëve.

Në këtë raport, termit “fëmijë” dhe “fëmijë dhe adoleshentë” përdoren në përputhje me kontekstet përkatëse të kornizave ligjore dhe ofrimit të shërbimeve. Derisa legjislacioni në Kosovë u referohet individëve nën moshën 18-vjeçare si “fëmijë”, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, shërbimet shpesh bëjnë dallim midis “fëmijëve” (zakonisht moshat 0 – 12-vjeçar) dhe “adoleshentëve” (13 – 18-vjeçar) për të adresuar nevojat specifike zhvillimore të këtyre grupeve. Ky dallim synon të sigurojë qartësi dhe saktësi në përfaqësimin e perspektivave ligjore dhe atyre të shërbimeve të shëndetit mendor.

BAZA LIGJORE

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta) dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit³ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), pos të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);
- Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);
- të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);
- të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së

¹ American Psychological Association. Mental health is a state of mind: <https://www.apa.org/topics/mental-health>

² World Health Organization. Mental health: strengthening our response: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/mental-health-strengthening-our-response>

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/, 26 qershor 2015³, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>.

Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);

- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit)."

KORNIZA LIGJORE DHE ANALIZA E ÇËSHTJES

2. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)⁴, në nenin 24, paragrafi 1, përcakton: "*1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.*" Për zbatimin e plotë të kësaj të drejte, institucionet shtetërore duhet t'i ndërmarrin masat e duhura për t'ua siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor.⁵
3. KDF-ja në nenin 19, paragrafi 1, përcakton: "*Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.*" Ndërsa KDF-ja në nenin 23 garanton të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuar për përkujdesje dhe mbështetje shëndetësore duke siguruar respektim të dinjitetit dhe të përfshirjes në komunitet.
4. Komenti Gjeneral Nr. 15⁶ për të drejtën e fëmijës për gëzimin e së drejtës në standardin më të lartë të jetesës, synon të ofrojë udhëzime dhe mbështetje për shtetet pjesëmarrëse për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për standardin më të lartë të shëndetit. Paragrafi 2(b), neni 24 i KDF-së: "*Sigurimi i ndihmës së nevojshme mjekësore dhe përkujdesjes shëndetësore për të gjithë fëmijët me fokus zhvillimin e përkujdesjes primare shëndetësore.*" Pika 38 e Komentit Gjeneral plotëson nenin 24, paragrafi 2(b), duke theksuar rritjen e prevalencës së problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve, si: depresioni, ankthi, çrregullimet e ushqyerjes, traumat psikologjike si rezultat i abuzimit, neglizhenca, dhuna ose eksploatimi, alkooli, duhani, përdorimi i substancave, sjellja obsesive, përdorimi i tepërt i internetit apo i teknologjisë, vetëlëndimi apo vetëvrasja. Komiteti përmes këtij Komenti thekson nevojën për një qasje në shëndetin publik dhe mbështetje psiko-sociale për t'i adresuar këto çështje, duke kërkuar të shmanget qasja mjekësore dhe institucionalizimi. Komiteti bën thirrje për fokus në identifikim të hershëm dhe trajtim të vështirësive psiko-sociale, emocionale dhe mendore në kujdesin parësor. Pika 39 e Komentit Gjeneral plotëson gjithashtu nenin 24, paragrafi 2 (b), duke theksuar se shtetet kanë për obligim të ofrojnë trajtim dhe rehabilitim të përshtatshëm për fëmijët

⁴ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989: [https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf). Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi zbatimi krahasuar me aktet e tjera ligjore vendore në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

⁵ KDF, neni 24, paragrafi 2, pika b.

⁶ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 24/6: Shëndeti mendor dhe të drejtat e njeriut, A/HRC/RES/24/6, miratuar më 8 tetor 2013, në dispozicion në: <https://digitallibrary.un.org/record/778524?ln=en&v=pdf>.

me çrregullime mendore dhe psiko-sociale duke shmangur medikamentet e panevojshme. Komiteti inkurajon shtetet të përdorin programe të dëshmuara të intervenimit në sektorë të ndryshëm, përfshirë shëndetësinë, edukimin dhe mbrojtjen, duke përfshirë familjen dhe komunitetin. Vëmendje e veçantë u kushtohet fëmijëve në rrezik për shkak të familjes dhe mjedisit social për të fuqizuar shkathtësitë e tyre ballafaqese dhe për të promovuar mjedise mbrojtëse dhe mbështetëse. Ndërsa pika 62 e Komentit Gjeneral plotëson paragrafin 2(f) të nenit 24, për kujdesin parandalues. Komiteti thekson se parandalimi dhe promovimi i shëndetit duhet t'i adresojë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen fëmijët në komunitet dhe vendi në tërësi. Këto sfida, ndër të tjerash, përfshijnë edhe problemet psiko-sociale dhe ato të shëndetit mendor. Parandalimi duhet të ndodhë në fazë të hershme përmes promovimit dhe mbështetjes së stileve të shëndetshme të jetesës për gratë shtatzëna, partnerët e tyre dhe fëmijët e vegjël.

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta) shprehimisht përcakton obligimin e respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut, konkretisht neni 50 i saj përcakton: *“1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni thotë: *“Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.”* Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut, ndërsa në rastet që kanë të bëjnë me fëmijët, të gjitha veprimet të ndërmarra, qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. Për vlerën të theksohet fakti se fëmijët e shëndetshëm mendërisht kanë një cilësi pozitive të jetës dhe mund të funksionojnë mirë në shtëpi, në shkollë dhe në komunitetin e tyre. Shëndeti i fëmijëve është njëri ndër komponentët kryesorë që ndikon në zhvillimin normal të fëmijës, prandaj intervenimi i hershëm dhe trajtimi i çështjeve të shëndetit mendor janë vitale për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve.
6. Ligji nr. 05/L-025 për Shëndet Mendor⁷ (në tekstin e mëtejshëm: LShM) ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore Ky ligj në nenin 5 ka përcaktuar parimet themelore të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor mbi të cilat mbështeten të gjitha dispozitat e tij: *“1.1. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor; 1.2. Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integritetin dhe rehabilitimin social; 1.3. Krijimi i lehtësirave përmes programeve dhe projekteve të cilat implementohen nga organet kompetente për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore; 1.4. Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekupe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit; 1.5. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore në përputhje me aktet ndërkombëtare të aplikuara në Kosovë; 1.6. Në të gjitha instancat ku personat janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, duhet të merret si faktor udhëzues gjatë marrjes së vendimit, parimi në interesin më të mirë të fëmijës.”*

⁷Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.33/23, 2015, Prishtinë:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>.

7. LShM-ja, në nenin 14 ka përcaktuar se shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët janë pjesë përbërëse e shërbimeve në të gjitha kategoritë e shërbimeve të shëndetit mendor, siç janë parashikuar në nenin 10, nënparagrafi 1.1⁸, nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1⁹, dhe në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1¹⁰ të këtij ligji. Në frymën e kësaj, gjatë marrjes së shërbimeve spitalore të shëndetit mendor, fëmijët nuk mund të vendosen në hapësira të përbashkëta me personat e rritur si dhe opinioni i fëmijës duhet të merret parasysh në rastet e trajtimit të pavullnetshëm dhe vendosjes së pavullnetshme, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.¹¹
8. Ligj për Shëndetësi¹² (në tekstin e mëtejshëm: LSh) ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor. Në zbatim të këtij ligji, përkatësisht nenit 18, është nxjerrë Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr. 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi nr.04/2020)¹³. Sipas këtij udhëzimi, në kuadër të veprimtarisë së kujdesit parësor shëndetësor hyjnë edhe shërbimet e shëndetit mendor.¹⁴ Ndërsa sipas Shtojcës 2 (pika 8) të këtij udhëzimi, shërbimet e shëndetit mendor në kujdesin parësor përfshijnë: Aktivitetet e lidhura me promovimin, komunikimin dhe edukimin; Njohjen dhe përcjelljen e problemeve të shëndetit mendor (si depresioni, ankthi, sulm paniku, identifikimi dhe referimi i psikozës, trajtimi dhe përcjellja e gjendjeve më të lehta, çrregullimet nga përdorimi i alkoolit dhe drogave, problemet e gjumit, lodhja kronike, ankesa të pashpjeguara somatike); Kujdesi parandalues dhe edukimi i pacientit/familjes (Skreningu dhe zbulimi i hershëm i çrregullimeve mendore, dhënia e informacionit dhe edukimi rreth kujdesit mendor, dhënia e informacionit dhe edukimi rreth trajtimit të sëmundjeve mendore, dhënia e informacionit dhe edukimi për përbalimin e sëmundjes; Menaxhimi i gjendjeve akute; Trajtimi me medikamente i pacientëve me pengesa mentale; Referimi në nivelin dytësor/tretësor për konsultim dhe trajtim spitalor; Bashkëpunimi ndërsektorial - shërbimet sociale, organet komunale etj.; Bashkëpunimi me shoqata të ndryshme, OJQ të cilat merren me shëndetin mendor; Bashkëpunimi me qendrat referente të shëndetit mendor. Rrjedhimisht, në bazë të dispozitave të LShM-së dhe LSh-së të cekura më lart del se përcaktohet ofrimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë në tri nivelet e përkujdesjes shëndetësore, pra në nivelin parësor, në Spitalet Rajonale dhe në Klinikën e Psikiatrisë.
9. Sipas Strategjisë së BE-së¹⁵ theksohet rëndësia e diagnostikimit të hershëm dhe qasjes në shërbime të shëndetit mendor. LShM-ja nuk përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijë për identifikim të hershëm të vështirësive në raport me shëndetin mendor. Sipas Udhëzimit nr.04/2020, kujdesi parësor shëndetësor ofron shërbime të screeningut për çrregullime të shëndetit mendor, të cilat mund të ndihmojnë në

⁸ LShM - Kujdesi shëndetësor parësor.

⁹ LShM - Departamentet e Psikiatrisë në kuadër të spitaleve të përgjithshme.

¹⁰ LShM - Klinikën e Psikiatrisë.

¹¹ LShM - neni 14, paragrafët 2 dhe 3.

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.13/07 maj 2013, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

¹³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=88008>

¹⁴ Udhëzimi nr. 04/2020, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9.

¹⁵ Komisioni Evropian, *Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancia Evropiane për Fëmijët*

identifikim fillestar të vështirësive. Mirëpo Avokati i Popullit vëren se duke qenë se këto shërbime nuk ofrohen nga profesionistë të shëndetit mendor, rrjedhimisht nuk mund të ofrohet as kujdes i specializuar. Për më tepër, kujdesi i specializuar për fëmijë me sfida të shëndetit mendor nuk parashihet nga LShM-ja dhe as nga Udhëzimi nr.04/2020.

10. Gjithashtu LShM-ja parasheh ofrimin e shërbimeve në kujdesin dytësor shëndetësor, përkatësisht në spitalet rajonale, duke lënë anash ofrimin e shërbimeve komunitare për fëmijë, përkatësisht në qendra të shëndetit mendor, gjë e cila bie në kundërshtim me parimet bazë të këtij ligj, përkatësisht me nenin 5, nënparagrafin 1.2: *“Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.”* Rrjedhimisht shërbimet komunitare për fëmijë duhet të përcaktohen qartë me LShM-në.
11. Sipas LShM-së, trajtimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër (trajtimi i vullnetshëm), miratimin për të miturit ose personat me zotësi të kufizuar për të vepruar e jep kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor. Në rastet kur i mituri ose personi me zotësi të kufizuar është në gjendje të shprehë mendimin e tij dhe megjithatë i është nënshtruar trajtimit me kërkesë të kujdestarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor, ai ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi të tillë, pranë gjykatës, me përfaqësim të pavarur.¹⁶ Megjithatë nuk përcaktohen qartë procedurat e një mase të tillë ankimore, gjë e cila mund të krijojë hapësirë për cenim të të drejtave të fëmijës. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se aktet nënligjore të cilat janë të autorizuar të nxirren në zbatim të LShM-së, ende nuk janë miratuar.
12. LShM-ja parasheh ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë në tri nivelet e përkujdesjes. Për sa i përket nivelit dytësor të përkujdesjes, IAP-ja është informuar se Qendra për Shëndet Mendor në Prizren ka ofruar shërbime të psikiatrisë për fëmijë dhe adoleshentë deri në vitin 2023, ndërkaq aktualisht, në mungesë të stafit adekuat, ky shërbim nuk ofrohet.¹⁷ Gjithashtu, Qendra e Shëndetit Mendor në Gjakovë pati deklaruar se në vitin 2024 pritet të funksionalizohet Qendra e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshentë, e ndërtuar në vitin 2017.¹⁸ Aktualisht nuk ka informacione publike në lidhje me këto shërbime dhe kontakti me qendrën nuk është arritur të realizohet. Më 16 shtator 2024 IAP-ja ka kërkuar disa informata lidhur me çështjen nga Qendra e Shëndetit Mendor në Gjakovë, por deri në publikimin e këtij raporti nuk mori përgjigje. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit t’i japë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me çështjen.¹⁹ Qendrat e shëndetit mendor në rajone të tjera nuk ofrojnë shërbime të shëndetit mendor për fëmijë. Rrjedhimisht institucionet e vetme të cilat ofrojnë shërbime për fëmijë janë spitalet rajonale. Në spitalet rajonale nuk ekzistojnë reparte të veçanta të psikiatrisë për fëmijë dhe adoleshentë, mirëpo shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë ofrohen në kuadër të reparteve të psikiatrisë për të rritur. Sipas të dhënave publike në ueb-faqen e Shërbimit

¹⁶ LShM- neni 19, paragrafi 2.

¹⁷ Qendra e Shëndetit Mendor – Prizren, komunikim, tetor 2024

¹⁸ Revista Psika, "Viti 2024 sjell Qendrën e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshent në Gjakovë," në dispozicion në: <https://revistapsika.com/viti-2024-sjell-qendren-e-shendetit-mendor-per-femije-dhe-adoleshent-ne-gjakove-lajm/>.

¹⁹ Ligji për Avokatin e Popullit, neni 24, paragrafi 4: *“Refuzimi apo dështimi për t’iu përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit konsiderohet pengim i punës së Avokatit të Popullit. Kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet e tij.”*

Spitalor dhe Klinik Universitar (ShSKUK)²⁰, del se: Në Spitalin e Gjilanit ofrojnë shërbime 3 psikiatër, ndërsa psikologu ofron shërbime ambulatorie tri ditë të javës; në Spitalin e Prizrenit ofrojnë shërbime 7 psikiatër, ndërsa nuk ka të dhëna publike nëse ka psikologë; në Spitalin e Mitrovicës nuk ka të dhëna publike në lidhje me profesionistët të cilët ofrojnë shërbime të shëndetit mendor; në Spitalin e Ferizajt 5 ditë në javë ofrohen shërbime ambulatorie nga psikologu; në Spitalin e Gjakovës, Reparti i Psikiatrisë ka Njësinë për Psikiatri të Fëmijëve dhe Adoleshentëve; në Repartin e Psikiatrisë janë të angazhuar 5 psikiatër dhe ofrohen shërbime psikoterapie; në Spitalin e Pejës ofrohen shërbime të psikiatrisë dhe psikoterapisë, mirëpo nuk ka të dhëna publike në lidhje me profesionistët e angazhuar; në Spitalin e Mitrovicës nuk ka të dhëna publike në lidhje me profesionistët të cilët ofrojnë shërbime të shëndetit mendor.

13. Ligji për Mbrojtje të Fëmijës (LMF)²¹, në nenin 1 ka përcaktuar qëllimin e tij: “[...] 1.2. të mbrojtë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3. të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës; [...] 1.5. garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik; [...]” Për më tepër, ky ligj thekson parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, interesin më të mirë të fëmijës dhe të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar në çështjet që ndikojnë jetën e tij. Gjithashtu ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet e prindërve dhe të kujdestarëve në mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve. Prindërit duhet të sigurojnë që fëmijët të kenë një zhvillim të plotë fizik, psikologjik dhe moral. Tutje ky ligj vendos detyrime për institucionet shtetërore dhe ato të qeverisjes vendore për të krijuar politika dhe shërbime që mbështesin mbrojtjen e fëmijëve.

14. Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare (LShSF)²² rregullon shërbimet sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike që hartojnë politika dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.²³ Ky ligj, pos të tjerash, parasheh krijimin e strehimoreve, të cilat ofrojnë shërbime të specializuara, por nuk kufizohet vetëm në këshillim psikologjik, kujdesin shëndetësor, bazuar në nevojat e fëmijëve²⁴, si dhe në nenin 61, paragrafi 3, parasheh qendrat e kujdesit ditor për përkujdesjen ditore dhe shërbime sociale: “3.1. Qendra e Kujdesit Ditor për fëmijë; 3.2. Qendra e Kujdesit Ditor për të rritur dhe të moshuar; 3.3. Qendra për shërbime sociale të specializuara.” Ndërsa paragrafi 4 i këtij neni ka përcaktuar se organizimi dhe fushëveprimi i qendrave për kujdes ditor rregullohet

²⁰ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, spitalet, në dispozicion në: <https://shskuk.rks-gov.net/>.

²¹ Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë: gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844.

²² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 1/5 janar 2024, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111>

²³ LShSF, neni 1.

²⁴ LShSF, neni 60.

me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria. Rrjedhimisht deri më tani ky akt nënligjor nuk është miratuar.

15. Tutje, LShSF-ja në nenin 62 ka përcaktuar: “1. Për përkujdesje për periudhë të shkurtër për fëmijët e braktisur, fëmijët me çrregullime në sjellje, personat e rritur me sjellje shoqërore negative, shtatzënat dhe nënat me fëmijë deri në një vit të jetës së fëmijës, të cilëve për shkak të pasigurisë materiale, të çështjes banesore të pazgjidhur, të marrëdhënieve familjare të çrregulluara, dhe të situatave të ngjashme, nevojitet përkujdesi i përkohshëm, si dhe personat e tjerë të cilët kanë nevojë për përkujdesje sociale urgjente, Ministria themelon Qendrën për pranim.[...]. 3. Në qendrën për pranim kryhet trajtimi diagnostiko-observator, si dhe ofrimi i masave të domosdoshme të mbrojtjes, si dhe aplikimi i masave shëndetësore-higjienike, edukativo-arsimore dhe masat psiko-sociale për plotësimin e nevojave ekzistenciale dhe të nevojave tjera të shfrytëzuesve [...]. 5. Organizimi dhe fushëveprimi i Qendrës për Pranim rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria.” Aktualisht ky akt nënligjor nuk është miratuar.
16. Sipas Rregullores (ZKM) Nr. 15/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Shëndetësisë, Shtëpia për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar Mendore tani është nënsektor i Institutit Special në Shtime (ISSh) dhe menaxhohet nga MSh.²⁵ Sipas kësaj rregulloreje, misioni i ISSh-së është të ofrojë shërbime dhe mbështetje të plotë dhe të përshtatshme për fëmijë dhe persona të rritur me aftësi të kufizuara intelektuale, duke siguruar përkujdesje të vazhdueshme dhe qasje në shërbime mjekësore, edukative dhe rehabilituese që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, zhvillimin e aftësive personale, sociale dhe integrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Tutje kjo rregullore në nenin 43, paragrafi 4, ka përcaktuar se në kuadër të ISSh-së bën pjesë “Sektori për kujdesin ndaj fëmijëve”. IAP-ja ka biseduar me përfaqësuesit e ISSh-së, me ç’ rast ka vërejtur se të gjithë personat rezidentë janë mbi moshën 18-vjeçare, me vetëm një person të moshës 17-vjeçare.²⁶ Fakti se kjo qendër e dedikuar për fëmijë vazhdon të ketë rezidentë të moshës së rritur, është indikator për mungesë të hapësirës për të akomoduar fëmijë me aftësi të kufizuara mendore, të cilët mund të kenë nevojë për shërbime të shëndetit mendor 24 orë si dhe është vërejtur se nuk ka procedura ligjore me të cilin do të përcaktohen kriteret e pranimi, numrin e fëmijëve që mund të akomodohen, vlerësimin e nevojave dhe transferimin e fëmijëve rezidentë në ambiente të tjera.

POLITIKAT DHE PLANET STRATEGJIKE

Strategjia Evropiane për të Drejtën e Fëmijës (2022-2027)

17. Strategjia Evropiane për të Drejtën e Fëmijës²⁷ thekson rëndësinë e promovimit të të drejtave të fëmijëve, me fokus mirëqenien e përgjithshme. Kjo strategji avokon për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj të drejtave të fëmijëve që përfshin mirëqenien e përgjithshme në sektorë të ndryshëm, si: edukim, shërbime sociale dhe kujdes shëndetësor. Gjithashtu,

²⁵ Rregullore (ZKM) Nr. 15/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Shëndetësisë.

²⁶ Instituti Special i Shtimës, komunikim, tetor 2024.

²⁷ Komisioni Evropian, *Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancia Evropiane për Fëmijët*, në dispozicion në: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child/eu-strategy-rights-child-and-european-child-guarantee_en.

Strategjia e BE-së për të Drejtën e Fëmijës vë theks në nevojën e fëmijëve për të pasur qasje në shërbime shëndetësore të cilësisë së lartë. Po ashtu kjo strategji inkurajon përfshirjen e fëmijëve në proceset vendimmarrëse në lidhje me shëndetin e tyre. Masat parandaluese dhe intervenimi i hershëm për të adresuar sfidat shëndetësore janë një fokus tjetër i kësaj strategjie. Po ashtu, strategjia në fjalë bën thirrje për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna, abuzimi, diskriminimi, si dhe thekson nevojën për mbështetje për grupet e cënueshme. Përgjithësisht, Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve synon të krijojë një ambient ku mirëqenia dhe të drejtat e fëmijëve prioritetizohen. Ndër të tjera, Komisioni Evropian u bën thirrje shteteve për t'i konsideruar fëmijët si grup target me prioritet në strategjitë nacionale për shëndet mendor, duke krijuar rrjetëzim me familjet, shkollat, rininë dhe institucione të tjera të përfshira në shëndetin mendor të fëmijëve.

Strategjia e Shëndetit Mendor e Kosovës 2008 – 2013

18. Strategjia e Shëndetit Mendor e Kosovës²⁸ paraqet një plan për përmirësim të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë, me fokus integrimin e përkujdesjes spitalore dhe komunitare dhe luftimin e stigmës. Objektivat kryesore përfshinin zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në përputhje me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Ky plan fokusohet në parandalim, trajtim multidisiplinor, rehabilitim psiko-social dhe koordinim ndërmjet sistemit social dhe të drejtësisë. Për sa i përket shëndetit mendor të fëmijëve, kjo strategji përfshin bashkëpunimin me shkolla fillore dhe të mesme për promovim të shëndetit mendor, si dhe ofrimin e programeve trajnuese për mësimdhënës në tematika të shëndetit mendor. Gjithashtu thekson nevojën për zhvillim të shërbimeve të shëndetit mendor, veçanërisht për fëmijë dhe adoleshentë.

Plani i Veprimit i Shëndetit Mendor pas Pandemisë COVID-19, 2020-2021

19. Plani i Veprimit i Shëndetit Mendor pas Pandemisë COVID-19, 2020-2021²⁹ adreson sfidat e shëndetit mendor të përkeqësuar nga pandemia. Ndër të tjera, ky plan i veprimit adreson nevojat e fëmijëve dhe të adoleshentëve duke pasur parasysh se janë grup i ndjeshëm ndaj efekteve të pandemisë. Plani fokusohet në parandalimin e sfidave të shëndetit mendor të fëmijët duke adresuar faktorët si stresi dhe ndikimi i izolimit. Plani i veprimit përcakton përshtatjen e udhëzuesve klinikë për trajtimin e problemeve të shëndetit mendor të adoleshentët, përfshirë çrregullimet e përdorimit të substancave. Plani thekson nevojën për trajnime për edukatorët dhe ofruesit e shërbimeve, për të ndihmuar identifikimin e hershëm të shenjave të sfidave të shëndetit mendor dhe të dhunës në familje. Gjithashtu plani thekson nevojën për të promovuar mirëqenien mendore të fëmijët përmes masave parandaluese dhe ndërhyrjeve, duke pasur parasysh nevojat unike të fëmijëve në kontekstin pas pandemisë.

Strategjia shtetërore kundër drogave 2024-2028

20. Strategjia shtetërore kundër drogave 2024-2028³⁰ synon rritjen e kapaciteteve institucionale për investigim dhe parandalim të çështjeve të ndërlidhura me drogat, duke

²⁸ Republika e Kosovës, *Strategjia e Shëndetit Mendor 2008-2013*, në dispozicion në: <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Strategjia%20e%20Sh%C3%ABndetit%20Mendor%20%E2%80%93%202008-201357377120.8623.pdf>.

²⁹ Plani i Veprimit i Shëndetit Mendor pas Pandemisë COVID-19. Ministria e Shëndetësisë, në dispozicion në: <https://msh.rks-gov.net>.

³⁰ Republika e Kosovës, *Strategjia Kundër Drogave*, në dispozicion në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/3852/Strategjia%20kundër%20Drogave%20-%20shqip%20PDF.pdf>.

ofruar trajtim adekuat për përdoruesit dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Qëllimi i kësaj strategjie është reduktimi i prezencës dhe i konsumimit të drogave në Kosovë, kështu edhe minimizimi i pasojave negative dhe fuqizimi i një shoqërie të shëndetshme, të sigurt dhe aktive ekonomikisht. Kjo strategji potencon parandalimin e përdorimit të drogave nga fëmijët, veçanërisht në shkollë dhe në hapësira të tjera të rinjve. Gjithashtu strategjia planifikon aktivitete për t'i edukuar fëmijët për rrezikun e përdorimit të drogave, me qëllim menaxhimin e presionit nga bashkëmoshatarët, si një faktor që mund të çojë në eksplorim të drogave. Strategjia kundër drogave 2024-2028 përfshin masat për identifikim të hershëm dhe referim të fëmijëve në rrezik për përdorim të drogave dhe siguri i mbështetjes dhe trajtimit të duhur.

VLERËSIMI I SHËRBIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR PËR FËMIJË

Ministria e Shëndetësisë

21. IAP-ja ka zhvilluar intervista me përfaqësues të Divizionit të Shëndetit Mendor në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (në tekstin e mëtejshëm: MSh). Sipas tyre³¹, vërehet një angazhim në zhvillim të protokolleve klinike për të trajtuar disa çrregullime psikologjike, si: depresioni, ankthi, spektri i autizmit, çrregullimi obsesiv kompulsiv, çrregullimi i përdorimit të substancave etj., për fëmijët nga mosha 6-muajshe deri në 9-vjeçare. Duke qenë se intervenimi i hershëm është i rëndësishëm për të promovuar shëndetin mendor të fëmijëve, për t'i parandaluar sfidat psikologjike, si dhe për t'i trajtuar çrregullimet psikologjike të fëmijët,³² del se krijimi i udhëzuesve dhe i protokolleve klinike ndihmon procesin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe në kohë për fëmijë. MSh-ja, pos të tjerash, informoi se është hartuar një dokument për parimet e adoleshencës, plani i veprimit për shëndetin mendor si dhe është duke u hartuar një strategji për implementim të politikave për shëndet mendor. Tutje MSh-ja informoi se janë shtuar vizitat në familje në kuadër të kujdesit parësor, të cilat janë treguar të rëndësishme për t'i identifikuar rastet e trajtimit jo të dinjitetshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjatë periudhës janar - shtator 2024 janë realizuar 67 186 vizita në shtëpi, ndërsa në vitin 2023, në kuadër të vizitave për nënën dhe fëmijën, janë realizuar 42 004 sosh. Në kuadër të kujdesit parësor, MSh-ja planifikon përfshirjen e katër profileve të reja në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, siç janë: psikologët, fizioterapeutët, punëtorët socialë dhe logopedët, të cilët do t'i trajtojnë rastet me simptoma akute, si dhe ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme që të vendoset në prioritet intervenimi i hershëm me orientim të veçantë drejt politikave për rritjen dhe zhvillimin, veçanërisht të grupmoshave 0-3 dhe 3-6 vjeçare, por ende nuk ekziston një miratim përfundimtar për këtë.

Klinika e Psikiatrisë: Psikiatria e Fëmijëve dhe Adoloshentëve

22. Psikiatria e Fëmijëve dhe Adoloshentëve (PFA) është i vetmi repart i nivelit terciar që ofron shërbime ambulatorë dhe spitalore për fëmijë dhe adoleshentë. Në kuadër të këtij

³¹ Ministria e Shëndetësisë, intervistë, korrik 2024.

³² L. Hayes, R. Giallo, and K. Richardson, "Outcomes of an Early Intervention Program for Children with Disruptive Behaviour," *Australasian Psychiatry* 18, no. 6 (2010): 560–66 ; L. K. Koegel, R. L. Koegel, K. Ashbaugh, and J. Bradshaw, "The Importance of Early Identification and Intervention for Children With or at Risk for Autism Spectrum Disorders," *International Journal of Speech-Language Pathology* 16, no. 1 (2013): 50–56, <https://doi.org/10.3109/17549507.2013.861511>; E. J. Sonuga-Barke, J. Koerting, E. Smith, D. C. Mçann, and M. Thompson, "Early Detection and Intervention for Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder," *Expert Review of Neurotherapeutics* 11, no. 4 (2011): 557–63, <https://doi.org/10.1586/ern.11.39>

reparti janë të angazhuar tetë psikiatër për fëmijë, tre psikologe klinike, tre logopedë, shtatë infermierë, një pedagoge profesionale dhe në punëtor social.³³ PFA-ja, pos të tjerash, informoi se janë të angazhuar në hartimin e aktit juridik që përcakton kriteret e pranimit për shërbime të hospitalizimit për fëmijë; në hartimin e protokolleve për qasjen e parë në emergjencë psikiatrike, ku përfshihen mendimet/tendencat e vetëvrasjes, lëndimet e qëllimshme të vetes, agresiviteti, episodi akut apo kronik skizofrenik; në hartimin e aktit juridik në lidhje me procedurën e vlerësimit të parë, përcjelljes dhe lirimit. Për veç kësaj, PFA-ja informoi se numri i profesionistëve të angazhuar nuk mund t'i akomodojë kërkesat e pacientëve për vlerësim dhe trajtim, gjë e cila vështirëson edhe ndarjen e përgjegjësiave sipas prapavijave profesionale. Tutje gjatë vizitës në PFA u kuptua se psikiatrit ofrojnë vlerësime psikiatrike dhe trajtim, ndërsa psikologët klinikë janë të angazhuar kryesisht në vlerësime psikologjike. Kërkesa e madhe për vlerësime psikologjike (nga pacientët, por edhe nga qendrat për punë sociale) dhe numri i ulët i profesionistëve në raport me kërkesat e bën të pamundur ofrimin e shërbimeve të psikoterapisë nga specialistët e psikologjisë klinike. Si nevojë mjaft emergjente theksohet profilizimi i stafit dhe ndjekja e trajnimeve/programeve që i mundëson të profilizohet për menaxhim të simptomave të çrregullimeve të ndryshme.

23. Më 22 tetor 2024, përfaqësuesit e IAP-së vizituan Klinikën e Psikiatrisë në QKUK, përkatësisht PFA-në, që funksionon si pjesë e Klinikës Psikiatrike, me objekt ndaras, e cila ka 7 shtretër për hospitalizim të fëmijëve si dhe ofrohen shërbime ambulatorie ditore për moshat nën 18-vjeçare. Gjatë kësaj vizite, përfaqësuesit e IAP-së u njoftuan për mungesë të trajnimeve profesionale dhe për mbingarkesë në punë. Sipas tyre, në PFA ndodh që brenda muajit deri në 700 raste të fëmijëve të marrin shërbime, nga muaji maj kur edhe janë funksionalizuar dhomat me shtretër, deri 20 fëmijë janë hospitalizuar, ndërsa nuk ka staf të mjaftueshëm. Ky numër është shumë i madh pasi vijnë nga e gjithë Kosova, me që në regjione nuk kanë qendra të shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, përpos Gjakovës. Pra në Klinikën e Psikiatrisë ka mungesë të stafit infermierë dhe të psikologëve klinikë, aktualisht janë 3 psikologë në Psikiatrinë për Fëmijë dhe 2 psikologë në Psikiatrinë për të Rritur.

Psikologët shkollorë

24. Nga intervistat e realizuara me tre psikologë të shkollave vërehet se nuk ka një unifikim të planeve të punës dhe të aktiviteteve të psikologëve të shkollave.³⁴ Në intervistat e realizuara, psikologët shkollorë raportojnë se përfshihen në promovim të mirëqenies psiko-sociale dhe emocionale të nxënësve, të këshillimit, të vlerësimit dhe të referimit, në orientim në karrierë, në menaxhim të stresit dhe të ankthit, në psiko-edukim, si dhe në aktivitete të tjera jashtë-kurrikulare, siç janë klube të ndryshme të nxënësve. Në rastet e identifikimit të vështirësive në nxënie, psikologët raportojnë se angazhohen në krijimin e planeve individuale të mësimi dhe ofrimin e mbështetjes. Psikologët shkollorë ballafaqohen me sfida gjatë punës duke filluar nga mungesa e hapësirës adekuate, mungesa e mjeteve të punës, si dhe mungesa e trajnimeve profesionale, të gjetura këto që gjejnë mbështetje edhe në raportin e Institutit të Psikologjisë dhe Shoqatës së Psikologëve Shkollorë.³⁵ Bazuar në të dhënat e nxjerra nga intervistat me psikologë të shkollave në tri

³³ Psikiatria e Fëmijëve dhe Adoloshentëve, intervistë, korrik 2024.

³⁴ Psikologë shkollorë, intervista, korrik-gusht 2024.

³⁵ <https://filozofiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/A8D33F2E-1822-4C57-91F3-6671CEB365AF.pdf>

qytete të Kosovës³⁶, del se drejtoritë përkatëse të arsimit nuk i përmbushin nevojat e psikologëve për ofrim të trajnimeve profesionale. Edhe pse është treguar progres në angazhimin e psikologëve shkollorë në shkollë, numri aktual i psikologëve është i pamjaftueshëm për t'iu përgjigjur numrit të nxënësve të cilët ballafaqohen me sfida të shëndetit mendor.

Shoqëria civile

25. Qendra për Informim dhe Përmirësim Social (QIPS) në raportin e vitit 2023 për shëndetin mendor³⁷ ka nxjerrë përfundime mbi sfidat shumëdimensionale në fushën e shëndetit mendor, duke vënë në theks të veçantë shkeljen e të drejtave të individëve me çrregullime mendore. Andaj siguri i një qasjeje cilësore ndaj shërbimeve të shëndetit mendor, me fokus të drejtat e njeriut, është vendimtar për ndërtimin e një shoqërie të barabartë dhe të shëndetshme.
26. Nga intervista e realizuar me përfaqësues të Down Syndrome Kosova (DSK)³⁸ është njoftuar se DSK-ja ka bashkëpunim me Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adolehentëve, me profesionistët e shëndetit mendor në spitale rajonale dhe së fundmi ofrojnë shërbime me bazë në komunitet në tërë Kosovën, projekt ky i mbështetur nga UNICEF-i dhe USAID-i. Po ashtu DSK-ja ofron shërbime në komunitete në bashkëpunim me qendrat për punë sociale dhe drejtoritë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Gjithashtu, DSK-ja ka informuar lidhur me kontributin e tyre që komunat e Republikës së Kosovës të kenë plane veprimi për personat me aftësi të kufizuara, përmes punëtorive të organizuara me përfaqësues të departamenteve të ndryshme.
27. Bazuar në të dhënat e organizatës joqeveritare Labyrinth³⁹, mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë nga 18-vjeçare në vitin 2018, në 16-vjeçare në periudhën e fundit, ndërsa mosha mesatare e përdoruesve aktual është 27-vjeçare. Përdorimi i substancave narkotike afekton ndjeshëm shëndetin mendor dhe zhvillimin e fëmijëve.⁴⁰ Të dhënat alarmuese për përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët theksojnë nevojën për intervenim të hershëm për t'i parandaluar sjelljet e rrezikshme dhe për të promovuar shëndetin e tyre mendor.

Të gjeturat nga anketa dhe të dhënat e tjera në lidhje me shëndetin mendor të fëmijëve

28. Në kuadër të këtij raporti është shpërndarë një anketë për të hulumtuar perceptimin e përgjithshëm për shërbime të shëndetit mendor për fëmijë, si dhe për të kuptuar më shumë për përvojat me këto shërbime. Ky pyetësor ka shënjestuar popullatën e përgjithshme dhe prindërit e fëmijëve të cilët kanë përfituar shërbime të shëndetit mendor në institucione publike shëndetësore. Anketa është shpërndarë në rrjete sociale, ku kanë marrë pjesë gjithsej 50 persona, 70% nga zona urbane. Tre nga të anketuarit kanë qenë prindër të fëmijëve të cilët kanë marrë ose marrin shërbime të shëndetit mendor. Këta të

³⁶ Prishtinë, Gjiilan dhe Prizren.

³⁷ Qendra për Informim dhe Përmirësim Social, *Hulumtimi mbi situatën e shëndetit mendor në Kosovë*, në dispozicion në: <https://www.qips-ks.net/ep-content/uploads/2023/Hulumtimi.pdf>.

³⁸ Down Syndrome Kosova (DSK), intervistë, shtator 2024.

³⁹ Labyrinth, komunikim, tetor 2024.

⁴⁰ Thompson, Kara, Gabriel J. Merrin, Megan E. Ames, dhe Bonnie Leadbeater, "Marijuana trajectories in Canadian youth: Associations with substance use and mental health," *Canadian Journal of Behavioural Science/Revue canadienne des sciences du comportement* 50, nr. 1 (2018): 17.

fundit kanë ofruar edhe të dhëna cilësore në lidhje me përvojat e tyre me shërbime të shëndetit mendor.

29. Nga 50 persona të cilët kanë marrë pjesë në anketë, të gjithë kanë raportuar se e shohin të rëndësishëm ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë në institucione publike shëndetësore. 92% e të anketuarve raportojnë se nuk ka shërbime të mjaftueshme të shëndetit mendor për fëmijë në institucionet publike shëndetësore. 60% e të anketuarve mendojnë se institucionet publike nuk ofrojnë shërbime kualitative të shëndetit mendor. Megjithatë, 66% nga ta raportojnë se nuk do të hezitonin të përfitonin nga shërbimet e shëndetit mendor në institucione publike. Hezitimi për të marrë shërbime psikologjike mund të vijë edhe si rezultat i stigmës⁴¹, e cila ende mund të jetë e pranishme në kontekste dhe situata të caktuara.




Fig. 1. Perceptimi mbi disponueshmërinë e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë

⁴¹ Shkëmbi, Fleura, Erika Melonashi, and Naim Fanaj. "Personal and public attitudes regarding help-seeking for mental problems among Kosovo students." *Procedia-Social and Behavioral Sciences* 205 (2015): 151-156.




Fig. 2. Perceptimi mbi cilësinë e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijë

30. Të gjeturat e kësaj ankete sugjerojnë se për personat të cilët kanë raportuar se hezitojnë të kërkojnë ndihmë profesionale në institucione publike të shëndetit mendor për fëmijë, ndër arsyt kryesore për një mendim të tillë janë përvojat paraprake të familjarëve/të njohurve, të cilët, sipas tyre, janë përballur me qasje joprofesionale, janë ndier të gjykuar apo ka pasur listë të gjatë të pritjes. Perceptimi i tillë mund të jetë i afektuar edhe nga infrastruktura jo e duhur, numri i ulët i profesionistëve apo mungesa e trajnimeve profesionale me fokus të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të gjetura këto që evidentohen edhe në raportin e QIPS-it.⁴² Të tjerë raportojnë se mungesa e stafit profesional si dhe mungesa e vëmendjes nga ta i bënë të hezitojnë të përfitojnë nga shërbimet publike të shëndetit mendor. 74% e të anketuarve raportojnë se në zonën ku ata jetojnë, institucionet publike shëndetësore nuk ofrojnë shërbime të mjaftueshme të shëndetit mendor. Ky rezultat i anketës gjen mbështetje edhe në faktin se shërbime profesionale të shëndetit mendor për fëmijë ofrohen vetëm në nivel terciar dhe në spitale rajonale, duke vështirësuar marrjen e shërbimeve në komunitet.
31. Për më tepër, të anketuarit konsiderojnë se shëndeti mendor është neglizhuar në Kosovës, gjë e cila reflektohet në mundësitë e pakta për zhvillim profesional të profesionistëve të shëndetit mendor dhe mungesë të shërbimeve të mirëfillta. Mungesa e psiko-edukimit dhe fushatave vetëdijësuese është një element tjetër i rëndësishëm që potencohet nga të anketuarit. Përveç kësaj, konsiderohet e rëndësishme që të shtohen shërbimet e shëndetit mendor edhe në nivelin parësor dhe dytësor të përkujdesjes, si dhe përveç diagnostikimit, në nivelin terciar të ofrohet edhe trajtim për sfida të shëndetit mendor. Kjo e gjetur e anketës mbështetet edhe nga të dhënat cilësore të mbledhura përmes intervistave në institucione, me ç’ rast në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoloshentëve⁴³ raportohet për

⁴² QIPS, Hulumtimi mbi situatën e shëndetit mendor në Kosovë.

⁴³ Psikiatria e Fëmijëve dhe Adoloshentëve, intervistë.

mbingarkesë të profesionistëve shëndetësorë dhe pamundësi për të ofruar shërbime të trajtimit përmes psikoterapisë, për shkak të numrit të madh të kërkesave për vlerësime psikologjike. Një element tjetër i rëndësishëm të cilin e theksojnë të anketuarit është nevoja për të kërkuar shërbime shëndetësore jashtë zonës ku jetojnë, shpeshherë edhe në sektorin privat, ku çmimet mund të jenë të papërbalueshme për një numër të madh të popullsisë.

32. Tre nga të anketuarit, të cilët kanë fëmijë që kanë marrë shërbime të shëndetit mendor në institucione publike shëndetësore, raportojnë se kualiteti i shërbimeve është jo i kënaqshëm, duke theksuar vështirësinë për të pasur qasje në ato shërbime atëherë kur kanë nevojë. Përveç kësaj, ata theksojnë se është e vështirë të kenë qasje në shërbime të shëndetit mendor përgjithësisht në zonën ku jetojnë. Ndër të tjerash, ata raportojnë se nuk janë të sigurt nëse të drejtat e fëmijëve të tyre respektohen në institucionet ku ata marrin ndihmë dhe nuk mendojnë se profesionistët që i ofrojnë ato shërbime kanë përgatitje adekuate profesionale.
33. Përgjithësisht, të gjeturat nga kjo anketë theksojnë numrin e pamjaftueshëm të shërbimeve, mungesën qasjeje në shërbime për shëndet mendor. Gjithashtu të anketuarit shfaqin dyshime në raport me cilësinë e shërbimeve publike të shëndetit mendor në Kosovë. Mungesa e trajnimit të mjaftueshëm profesional, mungesa e shërbimeve të mirëfillta, si dhe mungesa e besimit të përgjithshëm në institucione publike shëndetësore theksojnë nevojën urgjente për përmirësime në të gjitha nivelet e përkujdesjes, duke përfshirë kujdesin preventiv dhe koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve për t'i adresuar nevojat e fëmijëve.
34. Shëndeti mendor i fëmijëve është një çështje kritike, pasi janë faza kyçe për trurin dhe zhvillimin emocional. Globalisht, 10-20% e fëmijëve dhe adoleshentëve përjetojnë probleme të shëndetit mendor, megjithatë shumica nga ta nuk marrin përkujdesjen e nevojshme.⁴⁴ Qasja e kufizuar në shërbime të shëndetit mendor dhe stigma është një barrierë në përkujdesjen shëndetësore, veçanërisht në vendet në zhvillim.⁴⁵ Prevalenca e çrregullimeve të shëndetit mendor te fëmijët e vegjël është rreth 16-18%.⁴⁶ Intervenimi i hershëm është treguar i rëndësishëm për t'i trajtuar çrregullimet e ndryshme zhvillimore te fëmijët, si spektrin e autizmit⁴⁷, çrregullimit të Deficitit të Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit⁴⁸, çrregullimeve të sjelljes etj.⁴⁹

⁴⁴ World Health Organization (WHO), *Improving the Mental and Brain Health of Children and Adolescents* (2021), accessed October 23, 2024, <https://www.who.int/activities/improving-the-mental-and-brain-health-of-children-and-adolescents>.

⁴⁵ World Health Organization (WHO), "Mental Health: Promoting and Protecting Human Rights," accessed October 23, 2024, <https://www.who.int/news-room/questions-and-answers/item/mental-health-promoting-and-protecting-human-rights>.

⁴⁶ K. von Klitzing, M. Döhnert, M. Kroll, and M. Grube, "Mental Disorders in Early Childhood," *Deutsches Ärzteblatt International* 112, no. 21-22 (2015): 375 ; A. M. Skovgaard et al., "The Prevalence of Mental Health Problems in Children 1½ Years of Age—The Copenhagen Child Cohort 2000," *Journal of Child Psychology and Psychiatry* 48, no. 1 (2007): 62-70

⁴⁷ L. K. Koegel, R. L. Koegel, K. Ashbaugh, and J. Bradshaw, "The Importance of Early Identification and Intervention for Children With or at Risk for Autism Spectrum Disorders," *International Journal of Speech-Language Pathology* 16, no. 1 (2013): 50–56, <https://doi.org/10.3109/17549507.2013.861511>.

⁴⁸ E. J. Sonuga-Barke, J. Koerting, E. Smith, D. C. Mçann, and M. Thompson, "Early Detection and Intervention for Attention-Deficit/Hyperactivity Disorder," *Expert Review of Neurotherapeutics* 11, no. 4 (2011): 557–63, <https://doi.org/10.1586/ern.11.39>.

⁴⁹ L. Hayes, R. Giallo, and K. Richardson, "Outcomes of an Early Intervention Program for Children with Disruptive Behaviour," *Australasian Psychiatry* 18, no. 6 (2010): 560–66.

35. 50% e problemeve të shëndetit mendor manifestohen rreth moshës 14-vjeçare. Po ashtu rastet e vetëvrasjes renditen si një ndër shkaqet kryesore të vdekjes në mesin e adoleshentëve të moshës 15-19 vjeçare.⁵⁰ Shëndeti mendor i adoleshentëve është i rëndësishëm në sfera të ndryshme të jetës së tyre dhe mund të ketë efekte afatgjate edhe në moshën e rritur.⁵¹ UNICEF-i dhe OBSH-ja kanë krijuar një iniciativë të përbashkët për të adresuar shkallën e lartë të vetëlëndimit, vetëvrasjes dhe ankthit te të rinjtë. Kjo iniciativë ka për qëllim të vendosë në rend të parë shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve në agjendën globale me fokus në strategjitë për parandalim, identifikim të hershëm të vështirësive dhe trajtim.⁵² Sipas Asociacionit Amerikan Psikologjik, faktorët si: dinamikat në familje, mjedisi i shkollës, si dhe statusi socio-ekonomik afektojnë shëndetin mendor të fëmijëve, gjë e cila thekson rëndësinë e një konteksti mbështetës për zhvillimin e tyre.⁵³
36. Sipas raportit të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF), “Karta e Vlerësimit” numri i kërkesave nga fëmijët për shërbime të shëndetit mendor është rritur, përdërisa numri i profesionistëve të shëndetit mendor është tejet i kufizuar për t’i përballuar kërkesat dhe për të ofruar shërbime cilësore. Në kuadër të shërbimeve të shëndetit mendor në institucionet publike shëndetësore janë të punësuar 52 psikiatër, nga të cilët vetëm 7 psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë në nivel vendi. Gjithashtu janë vetëm 10 specialistë të psikologjisë klinike, 2 psikologë klinikë, 7 punëtorë socialë dhe 2 këshilltarë psiko-socialë, që zhvillojnë veprimtarinë në nivelin dytësor dhe tretësor shëndetësor.⁵⁴
37. Në bazë të anketës “Zërat e rinj”, 26% e fëmijëve të anketuar nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë për depresion ose trishtimin e tyre, 40.7% e tyre kanë shprehur dëshirë që t’i japin pikëpamjet e tyre në fushën e shëndetit dhe mirëqenies (duke përfshirë shëndetin mendor dhe fizik), ku 42.9% janë vajza dhe 36.0% janë djem.⁵⁵
38. Kosova, si shumë vende të tjera në rajon, ballafaqohet me sfida të ndryshme në raport me ofrimin e shërbimeve adekuatë të shëndetit mendor, veçanërisht në raport me fëmijët dhe adoleshentët.⁵⁶ Nuk ekzistojnë të dhëna në dispozicion mbi prevalencën e çrregullimeve të shëndetit mendor te fëmijët dhe nevojat e tyre në Kosovë. Megjithatë, bazuar në kërkesat për ndihmë, numri i rasteve të mundshme mund të jetë mjaft i lartë. Në një studim të realizuar me adoleshentë në shtatë rajone të Kosovës, 25-40% e tyre shfaqin shenja të problemeve në sjellje.⁵⁷ Gjithashtu, për të paktën 11 vjet pas luftës është raportuar për simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik, të depresionit dhe të

⁵⁰ World Health Organization (WHO), "Adolescent Mental Health," last modified February 2022, <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescent-mental-health>.

⁵¹ R. R. Althoff, F. C. Verhulst, D. C. Retteë, J. J. Hudziak, and J. van der Ende, "Adult Outcomes of Childhood Dysregulation: A 14-Year Follow-Up Study," *Journal of the American Academy of Child & Adolescent Psychiatry* 49, no. 11 (2010): 1105–16.

⁵² UNICEF, "Increase in Child and Adolescent Mental Disorders Spurs New Push for Action by UNICEF and WHO," 2019, <https://www.unicef.org/press-releases/increase-child-and-adolescent-mental-disorders-spurs-new-push-action-unicef-and-who>.

⁵³ American Psychological Association (APA), "Children's Mental Health," 2023, <https://www.apa.org/topics/children/mental-health>.

⁵⁴ https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2024/10/Raporti_Karta-e-vleresimit_verzioni-final.pdf

⁵⁵ <https://resourcecentre.savethechildren.net/pdf/Zerat-e-Rinj-2024.pdf>

⁵⁶ M. Shahini, L. Rescorla, J. Ėancata, and A. Ahmeti, "Mental Health Problems in Kosovar Adolescents: Results from a National Mental Health Survey," *Neuropsychiatr* 29, no. 3 (2015): 125–32.

⁵⁷ Po aty

ankthit të fëmijët.⁵⁸ Të gjetura e tjera në Kosovë theksojnë rëndësinë e adresimit të traumës ndër gjenerata dhe identifikimit të faktorëve rrezikues.⁵⁹

39. Gjatë vitit 2024 në Kosovë janë shënuar rritje të rasteve të vetëlëndimit, si rezultat i një sfide në rrjetin social Tik-tok. Në maj të vitit 2024 janë shënuar rastet e para⁶⁰, ndërsa në periudhën shtator-tetor 2024 është raportuar për dhjetëra raste të ngjashme në Kosovës.⁶¹ Rastet e vetëlëndimeve janë tregues i nevojës për parandalim dhe trajtim të problemeve të shëndetit mendor. Një nga shkollat të cilat kanë raportuar për raste të vetëlëndimit të nxënësit nuk ka psikolog shkolle. Punësimi i psikologëve shkollorë parashihet të bëhet në rastet kur shkolla ka më shumë se 1000 nxënës.⁶² Në bazë të një raporti të publikuar⁶³, 28% e psikologëve shkollorë janë të obliguar të punojnë në dy shkolla, ndërsa 12.1% në tri shkolla. Bazuar në këto të gjetura konsiderohet se numri i kufizuar i psikologëve në shkolla vështirëson angazhimin në parandalim të sfidave të shëndetit mendor dhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme.
40. Një tregues tjetër i nevojës për parandalim dhe trajtim të problemeve të shëndetit mendor është numri i lartë i vetëvrasjeve.⁶⁴ Bazuar në të dhënat ekzistuese, vetëvrasja është shkak i rreth 3% të vdekjeve në Kosovë, ku një e treta e rasteve të vetëvrasjes janë adoleshentë.⁶⁵ Në shtator të vitit 2024, disa organizata joqeveritare kanë dorëzuar petitionin për Projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes, me 13 mijë e 361 nënshkrime të mbledhura.⁶⁶ Përmes këtij peticioni, organizata joqeveritare “Linja e Jetës” dhe organizatat e tjera kanë kërkuar një ligj që rregullon shërbimet klinike për parandalim të vetëvrasjes, integrimin e parandalimit të vetëvrasjes në objektiva institucionale, shërbime dhe mbështetje sociale joklinike, mekanizma për reduktimin e qasjes në mjete vetëlënduese. Në këtë drejtim Avokati i Popullit konsideron se një akt ligjor për parandalim të vetëvrasjeve do të mund të shërbente në adresim të boshllëqeve në sistemin e përkujdesjes për shëndet mendor. Mirëpo, është e rëndësisë urgjente që fillimisht të krijohet një strategji për parandalim të vetëvrasjes, e cila fokusohet në veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren, si: mbështetja me bazë në komunitet; linja emergjente për parandalim të vetëvrasjes; krijimi i ekipeve për menaxhim të krizës;

⁵⁸ Schick, Matthias, Naser Morina, Richard Klaghofer, Ulrich Schnyder, and Julia Müller. "Trauma, mental health, and intergenerational associations in Kosovar Families 11 years after the war." *European journal of psychotraumatology* 4, no. 1 (2013): 21060.

⁵⁹ Hyseni Duraku, Zamira, Genta Jahiu, and Donjeta Geci. "Intergenerational trauma and war-induced PTSD in Kosovo: Insights from the Albanian ethnic group." *Frontiers in Psychology* 14 (2023): 1195649.

⁶⁰ "Vetëlëndimet Inspiruara nga TikTok dhe Rrjetet Sociale: Si Ndikojnë Tek Fëmijët," *Evropa e Lirë*, last modified, marrë në tetor 2024, <https://www.evropaelire.org/a/vetelendimet-inspiruara-nga-tiktok-rrjetet-sociale-femijet-/32977447.html>.

⁶¹ "Kosova Sheh Rritje të Vetëvendimit të Nxënësve, Ndërsa Psikologët në Shkolla Mungojnë," *Kallxo.com*, marrë në tetor 2024, <https://kallxo.com/lajm/kosova-sheh-rritje-te-vetelendimit-te-nxenesve-ndersa-psikologet-ne-shkolla-mungojne/>.

⁶² Udhëzim Administrativ Nr. 26/2013 për Zgjedhjen e Nëpunësve për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edukative – Arsimore Parauniversitare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, 2013, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10072>

⁶³ "Studimi mbi Kërkesat dhe Nevojat për Shërbimet Psikologjike dhe Shëndetin Mendor të Studentëve në Universitetin e Prishtinës", *Filozofiku*, marrë në tetor 2024, <https://filozofiku.uni-pr.edu/desk/inc/media/A8D33F2E-1822-4C57-91F3-6671CEB365AF.pdf>.

⁶⁴ "Rritja e Numrit të Vetëvrasjeve Shqetësuese në Kosovë", *Ekonomia*, marrë në tetor 2024, <https://ekonomia.info/sq/siguri/rritja-e-numrit-te-vetevrasjeve-shqetesuese-ne-kosove>.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ "Dorëzohet në Kuvend Peticioni për Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjes", *Betimi për Drejtësi*, marrë në tetor 2024, <https://betimiperdrejtesi.com/dorezohet-ne-kuvend-peticioni-per-projektligjin-per-parandalimin-e-vetevrasjes/>.

pajisja e mësimdhënësve, punëtorëve socialë, ofruesve të shërbimeve shëndetësore, policëve me shkathtësi për të vërejtur dhe reaguar ndaj rrezikut për vetëvrasje; si dhe fushatat vetëdijësuese për probleme të shëndetit mendor.

41. Më 18 nëntor 2024, IAP-ja mbajti një tryezë diskutimi në lidhje me shëndetin mendor të fëmijëve duke prezantuar të gjeturat preliminare të raportit për përgjegjësitë e shtetit në raport me mbrojtjen e fëmijëve. Duke theksuar disa nga të gjeturat, Avokati i Popullit tha se ekziston mungesë e mekanizmave sistematikë për identifikimin e hershëm të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor; kufizimi i qasjes në mbështetjen e specializuar psikologjike në kujdesin parësor dhe dytësor; nevoja për numër më të madh të psikologëve në shkolla. Për më tepër Avokati i Popullit tha se stigma dhe perceptimi negativ për shërbime psikologjike mbesin si barrierë për kërkimin e ndihmës psikologjike. Pjesëmarrësit që vinin nga fushat dhe profile të ndryshme, që kryesisht punojnë me fëmijë, kontribuan në diskutim duke shtuar, pos të tjerash: të punohet më shumë në identifikimin e hershëm të problemeve të fëmijët; të punohet më shumë në ngritjen e vetëdijes të prindërve në lidhje me stigmën; të punohet në trajtim më të dinjitetshëm dhe se komunat duhet t'i shtojnë resurset kur flitet për shëndetin mendor; të përfshihen profile të reja, si: psikologë, logopedë dhe fiziatër, në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor; të rritet numri i profesionistëve të specializuar; të krijohen procedura për marrjen e pëlqimit për hospitalizim të fëmijëve; të rritet numri i psikologëve dhe të themelohet e funksionalizohet organi i kujdestarisë në disa prej komunave ku nuk janë themeluar; nevojën për ekipe profesionale, mbikëqyrje të rregullt dhe trajnime profesionale për të përmirësuar shërbimet në shkolla.

KONSTATIMET

42. Avokati i Popullit vëren se ekziston mungesë e dispozitave specifike ligjore për intervenimin e hershëm dhe kujdesin parandalues për shëndetin mendor të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor. Pra mungojnë mekanizma sistematikë për identifikimin e hershëm të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor.
43. Avokati i Popullit vëren se shkollat dhe institucionet shëndetësore të nivelit parësor nuk e kanë trajnimin dhe përgatitjen e nevojshme për t'i identifikuar shenjat e hershme të shqetësimit mendor, gjë që çon në vonim të ndërhyrjeve psikologjike për fëmijë.
44. Avokati i Popullit vëren se ka qasje të kufizuara për mbështetje të specializuar psikologjike në kujdesin parësor dhe dytësor. Korniza ekzistuese ligjore nuk siguron ofrimin e mbështetjes së specializuar psikologjike në nivelin e komunitetit, veçanërisht në shërbimet e kujdesit parësor dhe dytësor. Kjo mungesë qasjeje vështirëson marrjen e kujdesit psikologjik të vazhdueshëm, veçanërisht për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme.
45. Avokati i Popullit vëren se ka shërbime të pamjaftueshme të shëndetit mendor për fëmijë në nivelin dytësor. Sipas LShM-së, shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët në nivelin dytësor ofrohen vetëm në spitalet rajonale, përkatësisht në repartet përkatëse të psikiatrisë. Megjithatë, këto reparte psikiatrike (përveç Gjakovës) nuk kanë njësi të veçantë për fëmijë dhe nuk ofrohen nga psikiatër të fëmijëve. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2015 për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, në nenin 32, paragrafi 4, të shërbimeve psikiatrike përmendet përfshirja e psikologut klinik për të rritur dhe në këtë udhëzim në kuadër të reparteve psikiatrike nuk

parashihet shërbimi i shëndetit mendor për fëmijë. Andaj jo të gjitha spitalet rajonale ofrojnë shërbime të psikologjisë klinike, gjë që kufizon cilësinë e kujdesit për fëmijët që kërkojnë mbështetje të specializuar.

46. Avokati i Popullit vëren se ka numër të vogël të profesionistëve të shëndetit mendor, përfshirë psikiatër të fëmijëve dhe psikologë klinikë, si në nivelin dytësor, ashtu edhe në nivelin tretësor të kujdesit, gjë që pamundëson ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijë.
47. Avokati i Popullit vëren se në nivelin parësor nuk ofrohen shërbime të specializuara për shëndetin mendor për fëmijë për t'i mbështetur fëmijët që përballen me sfida të shëndetit mendor dhe për ta parandaluar zhvillimin e problemeve psikike.
48. Avokati i Popullit konstaton se në Psikiatrinë e Fëmijëve dhe Adoleshentëve, numri i profesionistëve të angazhuar nuk mund t'i akomodojnë kërkesat e pacientëve për vlerësim dhe trajtim, gjë e cila vështirëson edhe ndarjen e përgjegjësi sipas prapavijave profesionale. Psikiatrit ofrojnë vlerësime psikiatrike dhe trajtim, ndërsa psikologët klinikë janë të angazhuar kryesisht në vlerësime psikologjike. Kërkesa e madhe për vlerësime psikologjike (nga pacientët, por edhe nga qendrat për punë sociale) dhe numri i ulët i profesionistëve në raport me kërkesat pamundëson ofrimin e shërbimeve të psikoterapisë nga specialistët e psikologjisë klinike.
49. Avokati i Popullit vëren se stigma dhe perceptimi negativ për shërbime psikologjike mbesin si barrierë për kërkimin e ndihmës psikologjike.
50. Avokati i Popullit vëren se Ligji për Shëndetin Mendor ka hyrë në fuqi më 8 dhjetor 2015, ndërsa ende nuk janë miratuar aktet nënligjore për zbatimin e tij.
51. Avokati i Popullit vëren se Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare ka hyrë në fuqi më 20 janar 2024, ndërsa ende nuk janë miratuar aktet përkatëse nënligjore për zbatimin e tij, sipas neneve 61, paragrafi 4, dhe 62, paragrafi 5.
52. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...].”*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë:

1. Hartimin e strategjisë kombëtare për shëndetin mendor të fëmijëve në Kosovë, e cila duhet të përfshijë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të përmirësuar shëndetin mendor të fëmijëve në nivel kombëtar. Kjo strategji duhet të adresojë, pos të tjerash, nevojat e ndryshme të fëmijëve duke ofruar mbështetje, trajtim dhe parandalim të sëmundjeve mendore, si dhe duke krijuar një mjedis që promovon mirëqenien mendore.
2. Përfshirjen në aktet normativo-juridike të çështjes së intervenimit të hershëm dhe kujdesi parandalues për shëndetin mendor të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor

dhe krijimin e mekanizmave të efektshëm për monitorimin dhe llogaridhënien e implementimit të politikave të shëndetit mendor të fëmijëve.

3. Përfshirjen në aktet normativo-juridike të ofrimit të shërbimeve të specializuara për fëmijë në nivelin parësor dhe dytësor të përkujdesjes shëndetësore për të siguruar shërbime të cilësisë së lartë.
4. Përfshirjen në aktet normativo-juridike të ofrimit të shërbimeve komunitare për fëmijë në kuadër të qendrave të shëndetit mendor në të gjitha rajonet e Kosovës, si dhe t'i rregullojë qartë procedurat për masa ankimore të të miturit në lidhje me vendimet për trajtim të problemeve të shëndetit mendor.
5. Hartimin e protokolleve të standardizuara për ofrim të ndihmës psikologjike, për të gjitha grup-moshat e fëmijëve.
6. Të përcaktohen procedurat e qarta të pranimit, rehabilitimit dhe të lirimit të fëmijëve në Sektorin për Kujdesin ndaj Fëmijëve, në kuadër të Institutit Special në Shtime, si dhe të rriten kapacitetet për numër të rezidentëve.
7. Të krijohet mekanizma për ta monitoruar dhe vlerësuar implementimin e politikave për shëndet mendor, si dhe për të siguruar se shërbimet që ofrohen respektojnë plotësisht dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës.
8. Të ofrohen trajnime të specializuara për profesionistë të shëndetit mendor për qasje dhe metoda të ndryshme, në mënyrë që t'i kenë përgatitjet adekuate për t'i adresuar problemet e shëndetit mendor të fëmijëve.
9. Të zhvillohen kampanja për shëndetin publik, me fokus rëndësinë e përkujdesjes së hershme për sfida të shëndetit mendor të fëmijët.
10. Të rekrutohen dhe të trajnohen psikiatër dhe psikologë klinikë në shërbimin sekondar dhe të krijohen ekipe të intervenimit në situatë krize, të cilat janë të qasshme 24/7 për t'i menaxhuar rastet akute, përveçse për të ofruar përkujdesje për pacientët e hospitalizuar. Këto ekipe duhet të jenë të trajnuara në teknika dhe përkujdesje emergjente për fëmijë.
11. Të rritet numri i psikologëve klinikë në Klinikën e Psikiatrisë për Fëmijë dhe Adoleshentë në Prishtinë.
12. Të identifikohen nevojat e stafit profesional për trajnime të vazhdueshme profesionale, në raport me shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, me fokus identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe metodave të përshtatshme të intervenimit.
13. Për zbatim të Ligjit për Shëndetin Mendor, t'i nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:

1. Përfshirja e shëndeti mendor në kurrikulat shkollore, për t'i mësuar nxënësit me shkathtësi bazë për t'u kujdesur për shëndetin mendor dhe për të kërkuar ndihmë kur është e nevojshme.
2. Plotësim-ndryshimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 26/2013 për Zgjedhjen e Nëpunësve për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale në Institucionet Edukative - Arsimore Parauniversitare, duke siguruar që së paku secili institucion edukativo-arsimor parauniversitar të ketë psikolog.

Ministrisë së Drejtësisë:

1. *Për zbatim të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta nxjerrë aktin nënligjore të paraparë në nenin 61, paragrafi 4.*
2. *Për zbatim të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, ta nxjerrë aktin nënligjore të paraparë në nenin 62, paragrafi 5.*

Komunës së Deçanit:

1. *Të ofrohen trajnime për mësimdhënësit dhe psikologët e shkollave për identifikim të hershëm të shenjave për probleme me shëndetin mendor dhe trajtimin e duhur të tyre.*
2. *Të rekrutohen psikiatër dhe psikologë klinikë në shërbimin primar si dhe të krijohen ekipe të intervenimit në situatë të krizës, të cilat janë të qasshme 24/7 për t'i menaxhuar rastet akute.*
3. *Të identifikohen nevojat e stafit profesional për trajnime të vazhdueshme profesionale, në raport me shëndetin mendor të fëmijëve, me fokus identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe metodave të përshtatshme të intervenimit.*
4. *Zhvillimi i fushatave lokale për rritje të ndërgjegjësimit për ta reduktuar stigmën për probleme të shëndetit mendor dhe për ta inkurajuar komunitetin për t'i mbështetur fëmijët të cilët ballafaqohen me sfidat psikologjike.*

Komunës së Dragashit:

1. *Të ofrohen trajnime për mësimdhënësit dhe psikologët e shkollave në identifikim të hershëm të shenjave për probleme të shëndetit mendor dhe trajtimin e duhur të tyre.*
2. *Të rekrutohen psikiatër dhe psikologë klinikë në shërbimin primar si dhe të krijohen ekipe të intervenimit në situatë të krizës, të cilat janë të qasshme 24/7 për të menaxhuar rastet akute.*
3. *Të identifikohen nevojat e stafit profesional për trajnime të vazhdueshme profesionale, në raport me shëndetin mendor të fëmijëve, me fokus identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe metodave të përshtatshme të intervenimit.*
